



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria – Vlada - Government
Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës
Ministarstvo Sredine, Prostornog Planiranja i Infrastrukture
Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructure

Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm / Kancelarija Generalnog Sekretara / Office of the General Secretary

DATE/A:	22.12.2025
REFERENC-Ë:	25/1269/MMPHI
PËR/ZA/TO:	“Ro Bin Stone” Sh.p.k, Klinë
CC:	
PËRMES/PREKO/THROUGH:	
NGA/OD/FROM:	Izedin Bytyqi U.D. i Sekretarit të Përgjithshëm të MMPHI
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Vendim

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, e ka shqyrtuar Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis të dërguar nga kompania e juaj sipas kërkesës me nr.prot.: 25/1269/100/DMM dhe pas shqyrtimit të bërë ka vendosur sikurse në draft vendimin e bashkangjitur kësaj letërpërcjellëse.

1. Vendimi për Pëlqim Mjedisor për kompaninë “Ro Bin Stoner” Sh.p.k, Klinës – për përpunimin, thërrmimin dhe seperimin e gurit gëlqeror në ngastren kadastrale nr. P-71010027-00857-3 Z.K. Dresnik, Komuna Klinë.

2. Shtojcë: Obligimet dhe detyrimet që dalin nga Ligji për Mbrojtjen e Mjedisit Nr. 03/L-025 (neni 31. pika 1, 2. dhe neni 35).

Me respekt,



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria – Vlada - Government

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës
Ministarstvo Sredine, Prostornog Planiranja i Infrastrukture
Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructure
Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm / Kancelarija Generalnog Sekretara / Office of the General Secretary

Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, në mbështetje të nenit 18 të Ligjit Nr. 06/L-113 për Organizimin dhe Funksonimin e Administratës Shtetërore dhe Agjencive të Pavarura, (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 7/01 Mars 2019), shtojcës 1 pika 10 të Rregullores (QRK) Nr. 02/2021 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, nenit 29, të Ligjit për Mbrojtjen e Mjedisit Nr. 03/L-025 si dhe dispozitave ligjore të Ligjit për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis Nr. 08/L-181, nxjerr këtë:

V E N D I M

Lëshohet Pëlqimi Mjedisor Kompanisë “Ro Bin Stone” Sh.p.k. Klinë për përpunimin, thërrmimin dhe seperimin e gurit gëlqeror, në ngastrën kadastrale Nr. P-71010027/00857-3 Z.K. Dresnik, Komuna Klinë, për koordinatat e bashkangjitura këtij draft vendimit

Nr	Y	X
1	7469977.47	4717070.27
2	7469926.98	4716998.31
3	7469865.74	4716955.35
4	7469802	4716980
5	7469747.03	4716970.03
6	7469712.71	4716989.07
7	7469733.25	4717008.88
8	7469766.89	4717020.57
9	7469901.64	4717010.91
10	7469915.09	4717018.04
11	7469962.93	4717075.65
12	7469498.83	4716538.93
13	7469492.9	4716581.7
14	7469400.32	4716802.68
15	7469343.77	4716765.52
16	7469342.1	4716518.31
17	7469307.34	4716450.57
18	7469467.89	4716471.97

nën kushtet si vijon:

- Gjatë punës (procesit teknologjik) duhet të ndërmerren të gjitha masat për evitimin e ndotjes së mjedisit nga mbeturinat e ngurta, evitimin nga derdhja e vajrave të makinave, evitimin nga derdhja e karburanteve e posaçërisht gjatë furnizimit të makinave;
- Të instalohet sistemi i spërkatjes në ajër me qëllim të parandalimit të përhapjes së pluhurit në ajër dhe bartjes me erë në pjesët e banuara me qytetarë
- Të bëhet sistemi për grumbullimin e ujërave nga sipërfaqet operationale, dhe të hapet kanali për rreth mihjes me qëllim të mbledhjes së ujërave atmosferike të ndotura dhe të orientohen në pusët sedimentuese për trajtimin e ujërave, në afat kohor prej dy muajsh nga dita e marrjes së këtij pëlqimi mjedisor;
- Të rregullohen pajimet për trajtimin e ujërave atmosferike nga sipërfaqet operationale (pusët sedimentuese dhe seperatori i vajrave), në afat kohor prej dy muajsh nga dita e marrjes së këtij pëlqimi mjedisor;
- Të vendosen pajimet adekuate për mbeturina të ngurta dhe lëngta;
- Bazuar në Ligjin e Ujërave Nr.04/L-147, neni 48, pika 1 dhe 1.3, me qëllim të mbrojtjes së shtretërve, brigjeve të ujërrjedhave, kanaleve, tuneleve, akumulimeve të ujërave, është e ndaluar: ndërtimi i objekteve tjera të cilat nuk shërbejnë për mbrojtjen nga përmbytjet, në largësi së paku tridhjetë (30) metra, nga vija e plotave të larta të ujërrjedhave dhe akumulimeve.
- Në kohra të nxehta të bëhet spërkatja e rrugës (pjesa e pa asfaltuar), kohë pas kohe me ujë, me qëllim të zvogëlimit të pluhurit gjatë transportit, gjithashtu kamionët gjatë transportit të gurit gëlqeror duhet të mbulohen me mbulesë adekuate;
- Pas përfundimit të projektit të kryhet rikultivimi i zonës së shfrytëzuar duke iu përshtatur projektit për rikultivim;
- Të bëhet thurra e ngastrës me tel gjëmbor.

Aplikuesi përpos kushteve të lartshënuara duhet të u përmbahet edhe kushteve të paraqitura në raportin e VNM-së.

Nëse nuk plotësohen kushtet e lartëcekura, pëlqimi do të anulohet (revokohet).

Arsyetim

Pas shqyrtimit të kërkesës për Pëlqim Mjedisor nga Komisioni për VNM, dokumentacionin përcjellës të dorëzuar, nga Kompania "Ro Bin Stone" Sh.p.k., Klinë për Pëlqim Mjedisor për veprimtarinë: për përpunimin, thërrmimin dhe seperimin e gurit gëlqeror, në ngastrën kadastrale Nr. P-71010027-00857-3 Z.K. Dresnik, Komuna Klinë, Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës nxjerrë Vendim për lëshuarjen e Pëlqimit Mjedisor.

Ky Pëlqimit Mjedisor lëshohet konform nenit 29, të Ligjit për Mbrojtjen e Mjedisit Nr. 03/L-025 si dhe dispozitave ligjore të Ligjit për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis Nr. 08/L-181

Faqe 3 nga 5

Operatori është i obliguar me Ligj, që të aplikoj për Leje Mjedisore

Ky Pëlqim Mjedisor vlen dy vite konform nenit 21 te Ligjit për VNM 08/L-181.

Ky vendim hyn në fuqi ditën e nxjerrjes.

Vërejtje: Afati i paraparë për shqyrtim të lëndës është tejkaluar për shkak të volumit të madh të kërkesa për VNM.

Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur mund të inicoj konflikt administrativ me padi në Gjykatën Themelore në afat 30 ditësh nga dita e pranimet e të njëjtit.

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës

Nr.: 25/1269/ - ZSP/ /25 datë: 22.12.2025

Prishtinë

T'i dërgohet:

1. Parashtruesit të kërkesës
2. Departamentit për Mbrojtjen e Mjedisit
3. Komisionit për VNM
4. Inspektoratit
5. AMMK
6. Kabinetit të Ministrit
7. Komunës së Klinës
8. Divizionit për Leje dhe Licenca Mjedisore
9. Divizionit për komunikim me publikun
10. Arkivit të MMPHI



U.D. i Sekretarit të Përgjithshëm të MMPHI

2. SHTOJÇË : Detyrimet që dalin nga Ligji për Mbrojtjen e Mjedisit Nr.03/L-025 për procedurën e mëtejshme, (neni 31. pika 1, 2. dhe neni 35).

Neni 31.

Leja Mjedisore

1. Lëshimi në punë i objektit të ndërtuar apo i stabilimenteve dhe pajisjeve që kanë qenë objekt i Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis, nuk mund të fillojë veprimtarinë pa marrjen e lejes mjedisore.

2. Leja mjedisore lëshohet për periudhën pesëvjeçare, sipas procedurës së përcaktuar për pranim teknik të objekteve dhe stabilimenteve ose pas kryerjes së punës provuese deri në gjashtë muaj, por gjithësesi para lëshimit në punë.

Neni 35.

Planet e intervenimit në rast të aksidentit mjedisor

1. Për rastet e aksidentit të mundshëm mjedisor ose të ndonjë ndodhie që posaçërisht e rrezikon mjedisin ose shëndetin e njeriut, Qeveria nxjerr plane të intervenimit dhe informon Kuvendin.

2. Planet e intervenimit nga paragrafi 1. të këtij neni përmbajnë: llojet e rrezikshmërisë; procedurat dhe masat për zbutjen dhe eliminimin e pasojave të drejtpërdrejta për mjedisin dhe shëndetin e njeriut; subjektet për zbatimin e masave të caktuara; përgjegjësitë dhe kompetencat lidhur me zbatimin dhe mënyrën e ndërmarrjes së masave për intervenim të cilat zbatohen sipas ligjit.

3. Planet e intervenimit për prodhimet, pajisjet dhe stabilimentet, të cilat me veprimtarinë e tyre mund të shkaktojnë ndotje të mjedisit, i harton prodhuesi.

4. Komuna është e obliguar të nxjerr planin e intervenimit për territorin e vet.

5. Përmbajtjen e planeve, procedurat dhe masat e zbatimit, subjektet e zbatimit të masave të caktuara, llojet e pajisjeve, stabilimenteve, dhe llojet e proceseve prodhuese sipas paragrafit 3. të këtij neni, Ministri e përcakton me akt nënligjor.

